

ARSIM SINANI**ZYRTARIZIMI I GJUHËS SHQIPE NË PËRPUTHJE
ME MARRËVESHJEN KORNIZË TË OHRIT**

Në këtë artikull, objekti i trajtimit do të jetë mënyra e zyrtarizimit të gjuhës shqipe, në përputhje me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit (MKO), me të cilën u vendosën kornizat e përdorimit të gjuhës shqipe në rrugë zyrtare. Çështja e zyrtarizimit të gjuhës shqipe ishte mjaft e ndërlikuar për shqiptarët që jetojnë në Maqedoni. Ligjet e aprovuara përmbanin lëshime dhe mangësi evidente, që ishin rezultat i një rezistence të palës maqedonase ndaj kësaj çështjeje. Diskriminimi i ushtruar ndaj shqiptarëve për një periudhë të gjatë ishte i tmerrshëm, ndërsa përdorimi i gjuhës shqipe shkoi në nivele më të ulëta, saqë preku edhe toponimet e qyteteve dhe të vendbanimeve të tjera që duhej të shqiptoheshin sipas natyrës së gjuhës maqedonase, me qëllim shtypjen e shqiptarëve dhe asimilimin gjuhësor e kulturor të tyre. Pala maqedonase në asnjë mënyrë nuk pajtohej me faktin se gjuha shqipe mund të përdorej lirshëm nga qytetarët shqiptarë të kësaj republike.

Në punim do të përqendrohemi kryesisht në rrafshin e kornizës së kësaj marrëveshjeje, brenda së cilës do të vihen në dukje përparësitë dhe mangësitë, sfidat dhe dështimet, interpretimet e gabuara dhe pengesat që i ka sot gjuha shqipe, si gjuhë zyrtare brenda institucioneve të Republikës së Maqedonisë (RM). Do të vihet në spikamë, përdorimi i gjuhës shqipe, me të gjitha baticat dhe zbaticat, në periudha të ndryshme, të errëta dhe të mundimshme, sidomos në rajonet ku shqiptarët më së shumti janë diskriminuar, si në Manastir, Ohër, Krushevë, Veles, madje edhe në Kumanovë e Shkup, ku ata për një kohë të gjatë kanë ëndërruar dhe po shpresojnë ende për përdorim zyrtar të gjuhës së tyre amtare.

Ka qenë një sfidë e vërtetë dhënia e vlerësimit për kapacitetin me të cilin po përdoret gjuha shqipe në institucionet shtetërore. Në këtë drejtim ka konfuzione dhe paqartësi, sepse në Maqedoni ka institucione që e përdorin gjuhën shqipe, ndaj dhe lehtësisht nënkuptohet se ato i drejtojnë shqiptarët, sikundër që ka institucione ku gjuha shqipe nuk përdoret, që

dëshmon se ato drejtohen nga kuadro maqedonase, të cilat nuk pranojnë edhe pas MKO-së që kjo gjuhë të përdoret lirshëm, pavarësisht se këtë e garanton kjo marrëveshje që solli paqen mes shqiptarëve dhe maqedonasve.

Parashtrimi i tezave për statusin politik-juridik të gjuhës shqipe në Republikën e Maqedonisë

Në mbështetje të informacioneve të grumbulluara, dokumenteve, shkresave arkivore dhe akteve të tjera të vlefshme të shumë institucioneve të Maqedonisë, dalin vlerësime relevante për nivelin e përdorimit të gjuhës shqipe. Në mbështetje të këtyre dokumenteve zyrtare dhe informacioneve të grumbulluara lidhur me çështjen e lëvruar, parashtrohen disa teza:

- Statusi politik dhe juridik i gjuhës shqipe në RM;
- Lufta e vitit 2001 dhe arritja e Marrëveshjes së Ohrit;
- Gjuha shqipe në labirintin e pafund legjislativ;
- Implikimet praktike të përdorimit të gjuhës shqipe në institucionet shtetërore të RM-së.

Në tërësi, ky është një hulumtim i kryer që nga viti 1994 e këndej, me grumbullim dhe sistematizim të materialeve nga shtypi, dokumenteve arkivore, video-incizimeve etj., dhe paraqet kronologjinë e një pune kërkimore në rrafshin e rrjedhave që kanë pasuar lidhur me përdorimin e gjuhës shqipe dhe obstrukcioneve në këtë aspekt.

Në vijim të parashtrimit të tezës, për herë të parë bëhet publike një dokument i nënshkruar në Parlamentin e Maqedonisë nga një zyrtar shqiptar dhe që është i rëndësishëm për ngritjen e mëtejshme të gjuhës shqipe drejt zyrtarizimit të plotë në të gjitha nivelet e Republikës së Maqedonisë¹. Po ashtu, këtu i shtohet fushës shkencore edhe një letër e panjohur, të cilën themeluesi i Universitetit të Tetovës, prof. dr. Fadil Sulejmani i ka dërguar profesor Ramadan Sinanit, gjatë kohës që ka qenë në burg, menjëherë pas themelimit të Universitetit të Tetovës, dokument ky që është nxjerrë nga sirtari personal, si trashëgimi e arkivit familjar².

¹ *Arkivi i Parlamentit të Maqedonisë*. Letër në gjuhën shqipe e deputetit Xhevat Ademi në cilësinë e kryetarit të Komitetit për marrëdhënie ndëretnike, drejtuar kryetarit të Kuvendit të Maqedonisë, numër 30-3699/2, Shkup, 1 shtator 2008.

² Letër e panjohur për opinionin publik e themeluesit të Universitetit të Tetovës, prof. dr. Fadil Sulejmani dërguar nga burgu profesor Ramadan Sinanit, e ruajtur

Tezës i bashkëngjis edhe dy letra të panjohura (të datës 10 shkurt 1994), që kongresisti amerikan Benjamin Gilman³ i dërgoi kolegut të vet Christofer Smith⁴, në lidhje me vizitën e ish-kongresistit amerikan, Josef Diogardi, që do të bënte me rastin e themelimit të Universitetit të Tetovës dhe që vlerësohet se janë me rëndësi historike për implikimin e lobit shqiptar dhe Kongresit Amerikan në këtë çështje me rëndësi për shqiptarët e Maqedonisë.

Hulumtimi i bërë me administratën e komunës së Tetovës, duke shqyrtuar të gjithë punonjësit e saj të nacionaliteteve të ndryshme, si shqiptarë, maqedonas, turq etj., ka patur si synim për të evidentuar se cilat janë pengesat me të cilat ballafaqohet përdorimi i gjuhës shqipe në Republikën e Maqedonisë⁵.

Gjatë hartimit të tezës jepen përgjigje për këto pyetje:

a) Cili ishte statusi i gjuhës shqipe në Republikën e Maqedonisë në periudhën deri në shkatërrimin e Jugosllavisë?

b) U avancua apo u reduktua gjuha shqipe pas pavarësimit të Republikës së Maqedonisë⁶?

c) Cilat ishin problemet praktike të reduktimit të përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe në Maqedoni?

ç) Lufta e vitit 2001 dhe, në kontekst të saj, cilat ishin kërkesat e shqiptarëve për gjuhën shqipe?

d) Cili ishte statusi i gjuhës shqipe me MKO?

dh) Cili ishte rregullimi kushtetues i gjuhës shqipe sipas MKO?

e) Në ç' masë u zyrtarizua gjuha shqipe pas konfliktit (MKO)?

ë) Sa përdoret konkretisht gjuha shqipe dhe cili është opinionimi i qytetarëve?

në arkivin personal të autorit. Për shkak të rëndësisë së tij historike dhe që të shërbejë për gjeneratat e ardhshme si një dëshmi e kohës, ky dokument origjinal është dorëzuar nga autori i këtij punimi në *Arkivin Qendror Shtetëror të Republikës së Shqipërisë* me numër protokolli: 4922, datë 19/12/2014.

³ *Congress of the United States*, House of representatives Washington DC 20515-3220 February, 10, 1995.

⁴ *Congress of the United States*, House of representatives Washington DC 20515-3004 February, 13, 1995.

⁵ Arsim Sinani, *Moszyrtarizimi i gjuhës shqipe konform Marrëveshjes së Ohrit*, Tiranë: UET Press, 2014, f. 239 (parathënie nga prof. dr. Blerim Reka).

⁶ *Po aty*, f. 2.

Statusi i gjuhës shqipe në Republikën e Maqedonisë në kuadër të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë

Gjuha shqipe, pas Luftës së Dytë Botërore kaloi në disa faza, gjatë të cilave u kërcënua jo vetëm ekzistenca e saj, por edhe e shqiptarëve si etnitet, një pjesë edhe u asimiluan me dhunë⁷, rasti i shqiptarëve ortodoksë të Maqedonisë. Pas ndarjes së Kosovës dhe hapësirave shqiptare në Maqedoni, Luginës së Preshevës e Bujanovcit⁸, shqiptarët i humbën të drejtat që i kishin në periudhën e mëparshme. Shkollat e para shqipe që ishin hapur, kishin problemet e veta, sepse pushteti jugosllav-serb kishte një strategji, për të larguar popullatën shqiptare nga arsimimi, me qëllim që të manipulonte me të më lehtë, kuptohet me idenë edhe për ta përzënë nga trojet e tyre⁹, ndërsa ata që ishin të shkolluar burgoseshin ose vriteshin¹⁰. Edhe bashkëpunëtorët e partizanëve jugosllavë kanë luajtur një rol jashtëzakonisht negativ, sepse duke mbrojtur parimet e Jugosllavisë së Titos dhe të kësaj doktrine, ishin vënë në shërbim të persekutimit të gjuhës shqipe, arsimimit dhe edukimit të shqiptarëve. Por, kjo do të zgjasë deri në vitin 1969, kur gjuha shqipe në Kosovë u sanksionua me ligj si gjuhë e dytë zyrtare, pas asaj serbo-kroate. U legalizua përdorimi i Flamurit Kombëtar Shqiptar, ndërsa në shkurt të vitit 1970 u themelua edhe Universiteti i Prishtinës¹¹.

Po ashtu, edhe mbajtja e Kongresit të Drejtshkrimin në Tiranë do të luajë një rol të rëndësishëm në inspirimin e punonjësve arsimorë, si dhe

⁷ Branko Manojlovski, *Reka e Epërme dhe fshati Kicinicë (Upper Reka and Kicinicë village)*, Tringa design, 2016, f. 20. Rrëfim i një shqiptari të Rekës se si janë asimiluar me dhunë nëpër shkolla që nga viti 1948. Shih edhe A. Sinani, *Moszyrtarizimi i gjuhës shqipe konform Marrëveshjes së Ohrit ...*, f. 11.

⁸ Shqiptarët e Luginës së Preshevës dhe Bujanovcit edhe sot ballafaqohen me probleme elementare në arsimin fillor dhe të mesëm pasi Republika e Serbisë ua ndalon tekstet shkollore nga Kosova dhe Shqipëria. Tani pas takimit të nivelit shtetëror Shqipëri-Serbi e me kërkesë të përfaqësuesve shqiptarë në Luginë, palët u dakorduan tekstet shkollore nga Republika e Shqipërisë të përdoren për nevoja të arsimit shqip atje, 14 tetor 2016. Deklaratë e kryetarit të Preshevës, Shqiprim Arifi në edicionin e lajmeve të Radio Kosovës, ora 15.

⁹ Skënder Hasani, *Dëshmi për Shkupin shqiptar (Dokumente)*, Shoqata e historianëve shqiptarë në Maqedoni, Shtëpia botuese Shkupi 2011, f. 21.

¹⁰ *Po aty*, f. 22.

¹¹ Violeta Hyseni, “Shërbimi në gjuhën shqipe”, *BBC*, e dielë, datë 17 shkurt 2008, 06:41.

të një pjese të intelektualëve shqiptarë nga Maqedonia, që do të angazhohen në ato momente shumë të rëndësishme për shqiptarët në zhvillimin e mëtejshëm të tyre në sferën e arsimit dhe të kulturës¹².

Kushtetuta e vitit 1974 e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ) avancoi të drejtat e shqiptarëve dhe gjuha shqipe u bë gjuhë zyrtare. Ky ishte avancimi më i madh që gjuha shqipe përjetoi në RSFJ.¹³ Kjo Kushtetutë do t'i avanconte edhe të drejtat e shqiptarëve, kështu që krahas gjuhëve të tjera, edhe gjuha shqipe do të bëhej gjuhë zyrtare. Moment po ashtu shumë i rëndësishëm në këtë proces ishte hapja e Universitetit të Prishtinës, që garantonte përdorimin më të madh publik të gjuhës shqipe*. Mund të thuhet se shqiptarët përjetuan një revolucion kulturor nga hapja e Universitetit të Prishtinës, prej nga dolën shumë kadro që mungonin nga koha e qeverisjes së shtetit shqiptar të viteve 1941-1944 në këto hapësira. Kështu, gjuha shqipe u avancua në gjuhë zyrtare në Jugosllavi**, e me këtë edhe në Republikën e Maqedonisë. Mirëpo, pavarësisht nga kjo, drejtuesit komunistë shqiptarë në Maqedoni ishin të pafuqishëm për t'i zbatuar në jetë këto të drejta, sepse para tyre ishte pengesë Partia Komuniste e Maqedonisë (PKM)¹⁴, më vonë LKM. Dihen veprimet e komunistëve shqiptarë, të cilët ishin më të zëshëm se maqedonasit¹⁵, kur bëhej fjalë për hapjen e shkollave shqipe apo

¹² Intervistë me prof. dr. Remzi Nesimin, i cili mori pjesë dhe është një nga nënshkruesit e Kongresit të Drejtshkrimit më 1972, mbajtur në Tiranë. Intervista është realizuar nga autori i këtij artikulli për nevoja të studimit, me datë 23. 07. 2013.

¹³ Qerim Lita, "Çështja shqiptare në RSFJ (1982-1990)", në *Përmbledhje punimesh dhe dokumente*, Botim i Shoqatës së Historianëve Shqiptarë, Shkup: 2014, f. 252.

* Deri atëherë institucioni i vetëm i shkollimit të lartë në gjuhën shqipe në Maqedoni ishte Akademia Pedagogjike në Shkup, që filloi me mësimin në gjuhën shqipe në vitin 1960.

** Me Kushtetutën e vitit 1974, gjuha shqipe fitoi statusin e gjuhës zyrtare në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ).

¹⁴ *Državen Arkiv na Republika Makedonija*, Skopje (më tej: *DARM*), Centralen Komitet na Sojuzot na Komunistite na Makedonija, pretsedatelstvo darm 1427.506.28/289-299 Skopje, february, 1987 godina ostvrt 9 sednica na CK SKJ

¹⁵ Intervistë e realizuar nga autori i këtij artikulli për nevojat e studimit me profesor Musa Arifin, datë 10 shkurt 2006. Xhemail Vejseli, një funksionar komunist i kohës i kishte thënë profesor Musa Arifit, pas arrestimit më 1949 të vëllait tim, profesor Abdylqerim Arifi, ndërkohë që vëllai i tij profesor Sulejman Arifi, ishte në arrati se: "Emri yt, në Komitetin Qendror është i shkruar me shkronja të zeza, ti

paraleleve në gjuhën shqipe. Në këto rrethana, pas hapjes së Akademisë Pedagogjike në Shkup (1960)¹⁶, u hap edhe Katedra e gjuhës shqipe në Universitetin e Shkupit, si rezultat i presionit të demonstratave dhe pakënaqësisë së shqiptarëve. Filloi hapja e shkollave të mesme dhe shqiptarët i morën në duart e veta punët që kishin të bëjnë me ta si dhe me edukimin e tyre, pavarësisht se pengesa kishte në çdo hap.

Injorimi i rinisë shqiptare për t'u shkolluar në Universitetin e Shkupit

Pas demonstratave të vitit 1968¹⁷ në ish-RSFJ, shqiptarët filluan gradualisht që të fitojnë më shumë të drejta në përdorimin e gjuhës shqipe, në arsimimin e tyre, në hapjen e shkollave të reja e deri te hapja e Universitetit të Prishtinës¹⁸, si një proces i cili ndikoi në ngritjen kulturore, arsimore dhe shkencore të shqiptarëve në ish-Jugosllavi, e me këtë edhe të shqiptarëve në Maqedoni¹⁹. Ndonëse shqiptarët fituan të drejtat e tyre dhe Universiteti i Prishtinës u bë një vatër e rëndësishme e edukimit, arsimimit, ngritjes kombëtare, në ish Republikën Socialiste të Maqedonisë, punët nuk ecnin me ritmin e duhur dhe vërehej një tendencë e hapur për shtyrje e bllokim të hapjes së shkollave të reja në gjuhën shqipe, të hapjes së paraleleve në gjuhën shqipe dhe arsimimit të shqiptarëve në Universitetin e Shkupit²⁰. Kjo tendencë vazhdoi në

je në radhë për t'u arrestuar. Këta shqiptarë komunistë ishin mjaft të dhunshëm dhe mbjellin frikë tek popullata”.

¹⁶ Intervistë e autorit të artikullit me prof. dr. Remzi Nesimin, realizuar më datë 12 shkurt 2012.

¹⁷ Beqir Berisha, *Kujtesë e hidhur*, Tetovë: Çabej, 2010, f. 80-82. Demonstratat e shqiptarëve në vitin 1968 kishin për qëllim përmirësimin e statusit të shqiptarëve në ish-Jugosllavi.

¹⁸ Intervistë për artikullin me prof. dr. Bujar Dugollin, më datë 14.12.2015.

¹⁹ A. Sinani, *Moszyrtarizimi i gjuhës shqipe konform Marrëveshjes së Ohrit...*, f. 15.

²⁰ Intervistë e autorit për nevoja të studimit me prof. dr. Blerim Rekën realizuar me datë 12 shtator 2013. Hapja e Universitetit të Shkupit në vitin 1946 nuk ndikoi fare në arsimimin e shqiptarëve, përkundrazi, të rinjtë shqiptarë diskriminoheshin dhe ata që pranoheshin mësonin në gjuhën maqedonase. Përveç kësaj, diskriminimi bëhej edhe gjatë notimit si dhe u nxirrnin pengesa të ndryshme.

Autori i këtij artikulli u regjistrua në vitin akademik 1992-1993 në Universitetin e Shkupit, pasi kishte bërë një vërejtje se ishte diskriminuar si shqiptar. Edhe pse u regjistrua në Fakultetin Juridik, dega e Gazetarisë, ai nuk arriti që t'i kryejë studimet, pasi diskriminohej nga profesorët maqedonas. Diskriminimi shkonte

mënyrë selektive nën kontrollin e aparatit shtetëror, prandaj shumica e studentëve shqiptarë u orientuan të studionin më mirë në Prishtinë se sa në Shkup²¹.

Diskriminimi i medias dhe politika zyrtare e Shkupit

Gjuha shqipe diskriminohej gjithandej nëpër të gjitha segmentet e jetës kulturore, shoqërore dhe politike. Programet radiotelevizive në gjuhën shqipe ishin aq të varfra dhe aq të kufizuara saqë mund të thuhet se reduktoheshin në 60 minuta për tërë ditën²². Dhe kjo me një redaktim e lekturë politike, që degjeneronin gjuhën shqipe nëpërmjet transmetuesve të devotshëm të pushtetit. Po ashtu toponimet e qyteteve dhe vendbanimeve shqiptare bëheshin me theks të gjuhës maqedone²³. Ideja ishte që edhe ato pak minuta të mbillnin frikën dhe të dëshpëronin shqiptarët, por edhe të mbaheshin nën një kontroll të rreptë.

deri në atë masë, saqë shqiptarët fyheshin me thirrjen “shqiptar” dhe atyre u krijoheshin pengesa të ndryshme. Autori duke i parë këto padrejtësi u detyrua të braktisë studimet.

²¹ Gëzim Ostreni, *Shpresa dhe zhgënjimi i shqiptarëve në Maqedoni gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore*, Instituti i Historisë, Prishtinë: 2000, f. 160.

Në vitin 1979-1980, vetëm në vitin e parë në Universitetin “Cirili dhe Metodi”, studionin 698 studentë shqiptarë, ndërsa në Kosovë dhe jashtë studionin mbi pesë mijë studentë shqiptarë nga Maqedonia.

²² Intervistë e autorit, realizuar me profesor Milaim Fejziun, datë 12 tetor 2015. Sipas tij: “Kjo ishte një strategji që u përdor në Kosovë me shumë sukses, duke krijuar terr informativ pas vitit 1989, kur Kosovës iu suprimua autonomia nga Kuvendi i Serbisë”.

²³ Q. Lita, “Çështja shqiptare në RSFJ (1981-1990)...”, f. 511.

Kjo ishte një iniciativë e tre akademikëve shqiptarë të Kosovës: Gazmend Zajmi, Idriz Ajeti dhe Rexhep Qosja drejtuar Gjyqit Kushtetues të RSFJ-së në lidhje me vlerësimin jokushtetues të aktiviteteve të RTV Shkupit në gjuhën shqipe. Akademik Gazmend Zajmi, Idriz Ajeti dhe Rexhep Qosja nga Kosova me këtë letër e kundërshtonin në gjuhë maqedone toponimin e qyteteve dhe vendbanimeve shqiptare nga Tetovë në Tetovo, apo Shkupi në Skopje. Në RTV Shkup dhe kërkonin abrogimin e vendimit të RTV Shkupit si flagrant dhe jokushtetues dokument i datës: 04.04.1988, drejtuar Gjyqit Kushtetues të Jugosllavisë, Beograd.

Gazeta “Flaka e Vëllazërimit” po ashtu ishte një vatër e informimit në gjuhën shqipe, e cila në mënyrë obliguese u shitej nxënësve²⁴ nëpër gjithë territorin e Maqedonisë. Ajo përmbante një politikë maqedonase, e cila nuk kishte të bënte asgjë me gjuhën shqipe, me interesat e komunitetit shqiptar, por ishte një megafon i pushtetit socialist, i cili shqiptarët mendohej t’i mbante të diskriminuar edhe në informim²⁵. Ky diskriminim i projektuar kishte për synim që të mbante nën kontroll të rreptë shqiptarët në Maqedoni. Radio Televizioni i Prishtinës rezultoi shumë i rëndësishëm dhe drejtuesit e Televizionit të Kosovës vendosën një antenë në Golesh*, prej nga u mundësohej shqiptarëve të Maqedonisë të përcillnin këtë program, i cili ndihmoi në ruajtjen e traditës dhe kulturës së shqiptarëve²⁶.

Universiteti i Shkupit midis arsimit dhe akulturimit

Në vitin 1946 ishte themeluar Universiteti i Shkupit dhe si i tillë u hap vetëm në gjuhën maqedonase. Edhe pse zyrtarisht quhej Universiteti i të gjitha kombeve dhe kombësive (sipas doktrinës Tito) i njëjti u hap për të plotësuar nevojat dhe kërkesat e popullatës maqedonase dhe jo shqipfolëse²⁷. Mësimi zhvillohej ekskluzivisht në gjuhën maqedonase dhe shqiptarët nuk kishin asnjë mundësi që të ishin pjesë e këtij procesi. Kjo zgjati deri me hapjen e Akademisë Pedagogjike²⁸, e cila u mundua

²⁴ Po aty.

²⁵ Po aty.

* Goleshi është një pikë e lartë në Republikën e Kosovës, prej nga mund të shihej një pjesë e territorit të Maqedonisë.

²⁶ Intervistë e autorit të artikullit me redaktorin e RTP-së Qani Mehmedi, realizuar më datë 11 tetor 2015.

²⁷ A. Sinani, *Moszyrtarizimi i gjuhës shqipe konform Marrëveshjes së Ohrit...*, f. 26.

²⁸ Intervistë e autorit për nevoja të studimit me prof. dr. Blerim Rekën, realizuar më 12 shtator 2013. Akademia Pedagogjike e Shkupit u hap më 1960. Në vitin e parë, një kontribut të jashtëzakonshëm dhanë profesorët Petro Janura dhe Hamza Reka. Më vonë, pas mbylljes në vitin 1987, u miratua Ligji për Fakultetin Pedagogjik (1997), me qëllim që pjesëtarët e nacionaliteteve të studiojnë në gjuhën amtare. Mirëpo, me hapjen e Fakultetit Pedagogjik, e drejta për arsim në gjuhën shqipe u ngrit në nivel të një fakulteti universitar. Me shumë vështirësi dhe sakrificë filloi edhe funksionimi praktik i këtij ligji. Është një ligj tipik politik, që ka për qëllim të eliminojë dhe të arsyetojë mospranimin e zyrtarizimit të Universitetit të Tetovës.

që t'i plotësojë kërkesat elementare për përgatitje të kuadrove për mësuesi dhe me kaq përfundonte plotësimi i kërkesave të shqiptarëve në Maqedoni. Vetëm në vitin 1965 filloi simbolikisht që studentët shqiptarë të jenë prezent në Universitetin e Shkupit.²⁹ Edhe pse gjuha shqipe u zyrtarizua në Maqedoni pati probleme posacërisht pas vitit 1981 duke synuar t'i përziejnë paralelet shqipe me ato maqedone me qëllim të mbylljes së paraleleve në gjuhën shqipe³⁰, plan që ekzistonte nga viti 1959.

Kjo periudhë e mbijetesës së arsimit shqip në rrethana të limituara zgjati deri në vitin 1994, kur strukturat shtetërore maqedonase, duke e parë rrezikun e frymës që vinte nga intelektualët shqiptarë të shkolluar në Prishtinë, ofruan si kompromis Akademinë Pedagogjike edhe në gjuhën shqipe, për të parandaluar projektin e Universitetit të Tetovës. Shqiptarët, edhe pse hezituan duke menduar se ndoshta kështu do të ishte më mirë³¹, një pjesë e inteligjencies kuptoi hilen që i përgatitej nga shteti maqedonas. Kjo shihet edhe nga dëshmitë e kohës ku thuhej se duhet patur kujdes me shqiptarët³², dhe nga nacionalizmi që vjen nga Kosova gjë që e vazhduan pasuesit e komunistëve maqedonas³³.

Universiteti i Shkupit dhe ideja që shqiptarët të mbaheshin nën kontroll dështoi plotësisht, shikuar nga këndvështrimi i sotëm. Këtu problem ka qenë edhe mosarsimimi i shqiptarëve pasi skanë ekzistuar shkolla³⁴. Por, kjo doktrinë nuk arriti të justifikojë veten, pasi kishte mllëfin brenda vetes. Ishte Universiteti i Prishtinës që deri në vitin 1992 luajti këtë rol të evitimit të pasojave asimiluese dhe shtypjes që bënin

²⁹ Tahir Zajazi, "Përfaqësimi i studentëve shqiptar në Universitetin e Shkupit (1946-1977)", në *Universitas*, viti III, nr. 4/5, qershor 2004, f. 117-133.

³⁰ DARM, Centralen Komitet na SKM, Izvren komitet kn.II BR.3-7 prim.I 1959 1.427.97.16/197-200.

³¹ Bisedë me prof. dr. Myrteza Ismaili, prorektor i parë dhe njëri nga themeluesit e Universitetit të Tetovës realizuar më 2 gusht 2010. Intervista u përqendrua në takimet e mbajtura mes intelektualëve shqiptarë në Shkup më 1993.

³² DARM, Centralen Komitet na Sojuzot na Komunistite na Makedonija, pretsedatelstvo darm 1427.506.28/289-299 Skopje, february, 1987 godina.

³³ DARM, Centralen Komitet na Sojuzot na Komunistite na Makedonija, pretsedatelstvo darm 142752745/517 strana 5.

³⁴ Xhevahir Shaqiri, "Ku kemi gabuar gjatë shekujve e ku po gabojmë sot e kësaj dite ?!", në revistën *Vlera*, nr. 6/7, Klubi letrar 94, Tetovë: shtator-tetor 1996, f. 22.

institucionet arsimore të Maqedonisë, ndërsa këtej e tutje ishte Universiteti i Tiranës³⁵ që u bë vatër e edukimit të brezit të ri të shqiptarëve të Maqedonisë, deri në hapjen e UT-së, por edhe më pastaj. Një pjesë e madhe e atyre që ligjëronin ishin kuadër i Universitetit të Prishtinës e Tiranës.

Statusi juridik i gjuhës shqipe pas pavarësimit të Maqedonisë Pavarësimi i Maqedonisë dhe fillimi nga zeroja për shqiptarët

Më 17 nëntor 1991, miratimi i Kushtetutës së Republikës së pavarur të Maqedonisë e varrosi gjuhën shqipe³⁶. Deputetët shqiptarë abstenuan nga votimi, por fizikisht ishin aty, pavarësisht nga mllefi që patën duke qëndruar në sallë³⁷. Ky ishte kthimi i gjuhës shqipe në pozitë pas vitit 1946³⁸. Kjo e provokoi rezistencën e shqiptarëve dhe një situatë e këtillë vazhdoi deri me nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit (2001)³⁹. “Maqedonia, dikur shtet i përbashkët i maqedonasve, shqiptarëve e të tjerëve, tash kontituohet si shtet nacional i maqedonasve që mishëron në vete trashëgiminë historike, kulturore, shpirtërore dhe shtetërore të

³⁵ Intervistë e realizuar me profesor Milaim Fejziun, datë 12 tetor 2015. Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Shkup ngriti një komision në nivel shtetëror, ku merrnin pjesë intelektualë të shquar si prof. Milaim Fejziu, prof. dr. Myrteza Ismaili, si dhe zyrtarë të ambasadës shqiptare, që bënë pranimin e dokumenteve të rinjve shqiptarë që të regjistroheshin në Universitetin e Tiranës, në pamundësi që të regjistroheshin në Universitetin e Shkupit. Kjo praktikë rezultoi shumë e suksesshme dhe luajti një rol jashtëzakonisht të madh në edukimin e të rinjve shqiptarë. Në 100-vjetorin e themelimit të shtetit modern shqiptar, kryetari i komunës së Shkupit të vjetër (Çairit), z. Izet Mexhiti shpalli “Qytetar Nderi” prof. dr. Dhori Kule, në shenjë falënderimi për të gjitha brezat që edukuan shqiptarët e Maqedonisë.

³⁶ Stojan Andov, Arhivski broj 08 4642/01, 17 noemvri 1991 godina, Skopje. Sobranie na Republika Makedonija brz основа на член 443 од Уставот на Република Македонија, Собранието на Република Македонија на седницата одржана на 17 ноември 1991 година, donese odluka za proglasuvanje na Ustavot na Republika Makedonija.

³⁷ A. Sinani, *Moszyrtarizimi i gjuhës shqipe konform Marrëveshjes së Ohrit...*, f. 31.

³⁸ *Doracak mbi legjislacionin kombëtar në sferën e përdorimit të gjuhëve të bashkësive etnike në Republikën e Maqedonisë*, Fondacioni Shoqëri e hapur-Maqedoni, Shkup: prill 2009, f. 21.

³⁹ A. Sinani, *Moszyrtarizimi i gjuhës shqipe konform Marrëveshjes së Ohrit...*, f. 20-31.

popullit maqedonas, për të gëlltur kështu me lehtësi neveritëse, trashëgiminë historike, politike, shpirtërore dhe shtetërore të popullit shqiptar”.⁴⁰

Pas hapjes së Universitetit të Tetovës, në vitin 2001 themelohet edhe një tjetër institucion në gjuhën shqipe, Universiteti i Evropës Juglindore (UEJL)⁴¹. Shqiptarët në këto procese u avancuan edhe me institucione përcjellëse si: Instituti për Trashëgimi Kulturorë e Shpirtërore të Shqiptarëve “Pjetër Bogdani”, me seli në Shkup.

Në Kushtetutën e re të Republikës së Maqedonisë (1991), gjuha shqipe u hoq nga përdorimi. Në (nenin 7) të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë thuhet: “Në Republikën e Maqedonisë gjuhë zyrtare është maqedonishtja dhe alfabeti i saj cirilik. Në njësitë e vetadministrimit lokal, në të cilat në masë të madhe jetojnë përfaqësuesit e minoriteteve, në përdorim zyrtar, krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit cirilik, janë edhe alfabetet dhe gjuha e nacionaliteteve, nën kushtet e rregulluara me ligj⁴². Shqiptarët u trajtuan pamëshirë, ndërsa përfaqësuesit shqiptarë në legjislacionin maqedonas, përveç se nuk e votuan Kushtetutën e Maqedonisë, nuk bënë ndonjë veprim më serioz⁴³.

Problemet e reduktimit të përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe Periudha 1990-2001 drejt një asimilimi kulturor e gjuhësor

Periudha më e vështirë për shqiptarët në Maqedoni ka qenë tranzicioni postjugosllav, sepse në këtë periudhë ka pasur një rënie totale të nivelit arsimor dhe një gjendje që kthehej në vitet pas vitit 1945⁴⁴, kur gjuha shqipe ishte në një pozitë të palakmueshme, madje edhe ishte e

⁴⁰ Arbër Xhaferi, “Maturia e pamatur”, në revistën *Vlera*, nr. 2-3 viti I, Klubi letrar 94, Tetovë: maj-qershor 95, f. 27-28.

⁴¹ Služben vesnik na RM 64/2000 sednica održana na: 17.09.2001 godina so tri prodolženja održani na: 20.09.2001 godina, 02.10.2001 godina i 09.10.2001 donese recenija za akreditacija na Proektot za osnivawe na Jugoistocno Evropski Universitet vo Tetovo.

⁴² Stojan Andov, Arhivski broj 08 4642/01, 17 noemvri 1991 godina, Skopje. Sobranie na Republika Makedonija vprz основа на член 443 од Уставот на Република Македонија, Собранието на Република Македонија на седницата одржана на 17 ноември 1991 година, donese odluka za proglasuvače na Ustavot na Republika Makedonija.

⁴³ A. Sinani, *Moszyrtarizimi i gjuhës shqipe konform Marrëveshjes së Ohrit...*, f. 34.

⁴⁴ James Pettifer, *The Macedonian question*, Palgrave: 2002, f. 96.

ndaluar në ish-RSFJ⁴⁵. Në një informacion të LKM-së që ishte lëshuar si qarkore thuhej: ”Mësimin duhet ta mbajë një profesor, paralelisht në të dyja gjuhët (maqedonisht dhe shqip), edhe atë duhej ta ligjëronte në mënyrë të kombinuar shqip-maqedonisht brenda një ore”⁴⁶. Kjo metodologji e cila u përdor në të kaluarën, u tentua të përdoret edhe në vitet kur Maqedonia u shkëput nga RSFJ.

Themelimi i Universitetit të Tetovës

Në takimet që mbaheshin në Kosovë, u ngrit nisma për themelimin e një Bashkësie kulturore, të quajtur Bashkësia Kulturore Shqiptare (BKSH)⁴⁷, e cila luajti një rol të rëndësishëm në ngritjen e vetëdijes kombëtare në vitet 1991-1992⁴⁸, e cila artikuloi dhe nxiti idenë e lëvizjes drejt zgjidhjes së problemeve të arsimit të shqiptarëve të Maqedonisë. Një frymë e cila do të rezultonte me mbajtjen e një takimi të intelektualëve shqiptarë, të cilët në sallën e Kuvendit Komunal të Tetovës morën një vendim shumë të rëndësishëm për themelimin e një universiteti në gjuhën

⁴⁵ *Veteranët e arsimit shqip në Tetovë e rrethinë (1940-1960)*, botim i Kuvendit Komunal të Tetovës, Tetovë: Arbëria design 2000, 2009 f. 6-7.

⁴⁶ *DARM*, kn. II br.3-3 prim I (1959.427.97.16/197-200).

⁴⁷ Enver Shala, gazeta *Flaka*, Shkup, 6 qershor 1994, f. 1-3.

Po ashtu shkrimi autorial i Abdullah Mehmetit, “Përvjetor - në 26-vjetorin e themelimit të Bashkësisë Kulturore Shqiptare”, në gazetën *Lajm*, 16 gusht 2016.

Kryetar i parë i Bashkësisë Kulturore Shqiptare ishte prof. dr. Fadil Sulejmani, nënkryetar mr. Ramadan Sinani dhe intelektualë të tjerë që vepronin në Kosovë. BKSH organizoi një cikël aktivitetesh që ishin për sensibilizim të shqiptarëve të Maqedonisë. Po ashtu, rinia studentore dhe një pjesë e atyre që dolën nga burgjet, filluan pajtimin e familjeve që ishin në gjak, një proces, i cili përfundoi me sukses.

Gazeta *Koha ditore*, Prishtinë, datë 6 qershor 2014. Ky universitet si institucioni i parë i arsimit sipëror me mësim në gjuhën shqipe në Republikën e Maqedonisë u themelua nga Kuvendi për Themelimin e Universitetit në Gjuhën Shqipe, i cili u mbajt në sallën e Kuvendit Komunal të Tetovës, me iniciativë dhe organizim të Bashkësisë Kulturore Shqiptare në Maqedoni.

⁴⁸ *Po aty*. Takimet e inteligjencies shqiptare bëheshin në ambiente shtëpie në Kosovë, që të mos binin në sy të organeve jugosllave. Në disa prej këtyre takimeve u vendos edhe për organizimin e jetës kulturore, arsimore, politike. Kështu që nga këto takime lindi Bashkësia Kulturore Shqiptare (BKSH). Bisedë me gazetarin dhe publicistin Qani Mehmedi, pjesëmarrës direkt në takime. Bisedë më 12 janar 2015.

shqipe⁴⁹. D.m.th. më 4 qershor 1994, në Tetovë Kuvendi i Intelektualëve Shqiptarë të rangut universitar nga Maqedonia që punon në Kosovë dhe Maqedoni, mori vendim: ngrihet iniciativë për themelimin e universitetit në gjuhën shqipe në Maqedoni, me seli në Tetovë. Themelimi i Universitetit të Tetovës do të ishte jetik për ruajtjen e gjuhës shqipe dhe edukimin e brezave të rinj⁵⁰. Nga ky takim ata , në deklaratën për opinionin publik theksojnë: “*Me këtë deklaratë e njoftojmë opinionin se Kuvendi i intelektualëve shqiptarë të rangut universitar mori vendim për themelimin e Universitetit në gjuhën shqipe në Maqedoni. Në rrethanat e krijuara në Maqedoni, pas shpërbërjes së Jugosllavisë, kur u vunë kufijtë e paligjshëm brenda territoreve tona etnike dhe u bë i pamundshëm studimi i shqiptarëve nga Maqedonia në Universitetin e Prishtinës, e më gjerë, si dhe të bojkotuar nga universitetet e Maqedonisë, që i financojnë edhe shqiptarët, intelektualët shqiptarë të rangut universitar nga Maqedonia e panë të arsyeshme që të mbajnë Kuvendin për ngritjen e iniciativës për themelimin e Universitetit me mësim në gjuhën shqipe në Maqedoni. Nga fakti se në këtë Republikë mijëra shqiptarë me shkollë të mesme e kanë të pamundshme t’i vazhdojnë studimet universitare, është nevojë e zhvillimit të natyrshëm e civilizues, marrja e këtij vendimi historik e human për ngritjen e kuadrove arsimore e shkencore të shqiptarëve në Maqedoni në gjuhën e tyre amtare*”.⁵¹ Kjo do të jetësohej më 16 dhjetor 1994⁵² kur edhe zyrtarisht do të shpallej se do të fillonte punë Universiteti i Tetovës. Edhe pse me ligjet e asaj kohe Universitetin

⁴⁹ *Po aty*. Intelektualët shqiptarë në Kosovë, të ndikuara nga rrethanat favorizuese në ish-Jugosllavi, e cila po shkonte drejt shpërbërjes, filluan takime intensive në të cilat bisedohej për pozitën e arsimit shqip në Maqedoni. Kjo do të kurorëzohej së fundmi, me themelimin e Universitetit të Tetovës. Intelektualët ishin nga të gjitha viset, një pjesë e tyre ishin të punësuar në Universitetin e Prishtinës.

⁵⁰ *Gazeta universitare*, viti III, nr. 3, janar 2007, f. 16, Deklaratë e prof. Fadil Sulejmanit me rastin e 12-vjetorit të themelimit të Universitetit të Tetovës.

⁵¹ Enver Shala, gazeta *Flaka*, Shkup, 6 qershor 1994, f. 3.

⁵² Konferencë për shtyp e krerëve të Universitetit të Tetovës, prof. dr. Fadil Sulejmani dhe prof. Milaim Fejziu, ora 17. Selia e Partisë së Prosperitetit Demokratik, 16 dhjetor 1994.

Autori i artikullit në cilësinë e gazetarit e ndoqi Konferencën për shtyp të krerëve të Universitetit të Tetovës, të cilët ishin në arrati dhe kërkoheshin nga policia maqedone për t’u arrestuar për shkak të nismës.

e themelonin tre komuna shqiptare (konform ligjeve ekzistuese⁵³), ajo e Tetovës, Gostivarit dhe Dibrës nuk u lejua ta shpallin aktin në Kuvendin Komunal të Tetovës⁵⁴, por shqiptarët e shpallën aktin⁵⁵. Rol shumë pozitiv luajtën intelektualë nga Kosova e Shqipëria⁵⁶, si edhe ambasada e Republikës së Shqipërisë, e cila e ndihmoi procesin⁵⁷. Por popullsia shqiptare vendosi që çdo shtëpi dhe pasuri që e disponon t'ia japë në disponim Universitetit të Tetovës⁵⁸, që të mbijetojë. Ndërsa, profesori

⁵³ Kushtetuta, e cila ishte aktualisht në përdorim, lejonte themelimin e komunaveshqiptare ashtu siç kishin vepruar ekspertët shqiptarë konform Kushtetutës së RSFJ-së. Bisedë me prof. Milaim Fejziun, 10 janar 2013.

⁵⁴ *Po aty*. Dokumentin e themelimit e kishin nënshkruar komunat shqiptare, partitë politike dhe institucionet kulturore, një ditë më parë, në një shtëpi në fshatin Recicë e Vogël. Bisedë me prof. Milaim Fejziun, 10 janar 2013.

⁵⁵ Artan Skënderi, drejtor i TV-Art, në bisedën për artikullin më datë 13.05.2015, deklaronte: “Filmimet e themelimit dhe aktit të nënshkrimit një natë më parë i nisëm për Televizionin shqiptar dhe të nesërmen ato u shfaqën në të gjitha edicionet e lajmeve në TVSH. Ishte një vepër që e bëmë me stafin tonë”.

⁵⁶ *Shqiptarët e e Maqedonisë*, botuar nga Meshiati i Bashkësisë Islame në Maqedoni, Shkup: 1994. Simpoziumi “Shqiptarë e Maqedonisë”, organizuar më 20-22 dhjetor 1991, mbajtur në Shkup ku morën pjesë intelektualë nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia si: Bahri Aliu, Xheladin Murati, Agim Zeka, Nevzat Halili, Ijaz Halimi, Taqo Zoto, Gjylimsere Kasapi, Muzafer Korkuti, Engjëll Sedaj, Skënder Anamali, Rexhep Doci, Qemal Murati, Mehmet Halimi, Muhamet Pirraku, Mahmut Hysa, Shefqet Pllana, Ali Vishko, Ramiz Abdyli, Ferit Duka, Teuta Arifi, Drita Statovci, Spiro Shkurti, Ali Muka, Edibe Selimi, Nuhi Vinca, Petrika Thëngjilli, Hamit Xhaferi, Shukri Rahimi, Ibrahim Krosi, Reshat Nexhipi, Haki Kasumi, Kristaq Prifti, Shaban Prevalla, Ruzhdi Lata, Gazmend Shpuza, Ejup Gashi, Gjyltekin Shehu, Hysni Myzyri, Dhimitër Dishnica, Veli Veliu, Limon Rushiti, Avzi Mustafa, Halim Purrellku, Marenglen Verli, Zamir Shtylla, Fatmira Rama, Vehbi Xhemali, Izber Hoti, Paskal Milo, Masar Kodra, Lefter Nasi, Xhelal Gjeçovi, Ukshin Hoti, Agim Vinca, Ismail Ahmeti, Feti Mhediu, Vehbi Bexheti, Fadil Sulejmani, Ana Lalaj, Tahir Zajazi, Jani Thomai, Remzi Nesimi, Lumira Berati, Ramadan Sinani, Hamdi Islami, Rrahmi Tuda, Asllan Selmani, Tefik Basha, Gazmend Kadriu, Abqylqerim Arifi e që ishte një kontribut i madh në shtyrjen para të procesit edukativ e arsimor të shqiptarëve të Maqedonisë solli edhe konkluzionet e veta.

⁵⁷ Milaim Fejziu, Fjalim me rastin e 3-vjetorit të themelimit të Universitetit të Tetovës, mbajtur në Akademinë Solemne kushtuar kësaj date, Gostivar, më 15.12.1997 (dokument origjinal i pabotuar nga arkivi personal i autorit).

⁵⁸ *Revista e Universitetit të Tetovës*, botuar nga Universiteti i Tetovës, 17 dhjetor 1997, f. 9.

Fadil Sulejmani u bë pengë për rrënimin dhe zhdukjen e Universitetit të Tetovës⁵⁹.

Zhvillimet politike në rajon do të ishin në disfavor të shqiptarëve të Maqedonisë. Por përpjekjet që shqiptarët të edukoheshin dhe të mbijetonte ky institucion si shumë i rëndësishëm për të ardhmen e shqiptarëve⁶⁰. Kjo ishte një rilindje kombëtare për shqiptarët⁶¹. Roli i Kosovës⁶² dhe i Shqipërisë⁶³ ishte jetik në mbijetesën e tij meqë u shpall ilegal nga shteti maqedon. Kjo do të ishte ndihma më e madhe nga institucionet e Shqipërisë dhe Kosovës⁶⁴, por edhe i intelektualëve shqiptarë që jetonin dhe vepronin jashtë⁶⁵.

**Sfidat e përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe
Pengesat ligjore, sanksionimi i Kushtetutës
njënacionale të RM (1991)**

Shqiptarët janë ballafaquar në vazhdimësi me pengesa nga më të ndryshmet dhe këto kanë qenë të sanksionuara me ligj. Ligjet janë interpretuar nga pala maqedonase sipas dëshirës dhe jo sipas realitetit

Shtëpia ku filluan ligjëratat e para në UT më 16 dhe 17 shkurt 1995 në Porojin legjendar, Tetovë, populli u vu në mbrojtje të universitetit para policisë si mur i gjallë. Në krye ishte lideri historik i shqiptarëve të Maqedonisë, Nevzat Halili.

⁵⁹ Intervistë e prof. dr. Fadil Sulejmanit dhënë Revistës së pavarur studentore të Universitetit të Tetovës, nr. 17, maj 2002, f. 4.

⁶⁰ *Po aty; Gazeta Universitare*, viti III, nr.3, janar 2007, f. 16, Deklaratë e prof. Milaim Fejziut me rastin e 12-vjetorit të themelimit të Universitetit të Tetovës.

⁶¹ *Po aty; Gazeta Universitare*, viti III, nr.3, janar 2007, f. 16, Deklaratë e prof. Remzi Nesimi me rastin e 12-vjetorit të themelimit të Universitetit të Tetovës.

⁶² *Po aty; Gazeta Universitare*, viti III, nr.3, janar 2007, f. 16, Deklaratë e prof. dr. Enver Hasani, opinion enkas për *Gazetën Universitare*. “Me UT-në më lidhin shumë fije”, f. 20-21.

⁶³ *Po aty; Gazeta Universitare*, viti III, nr. 3, janar 2007, f. 18, 19, Opinion enkas për *Gazetën Universitare*, Shezai Rrokaj, rektor i Universitetit të Tiranës, “Roma nuk është bërë për një ditë”.

⁶⁴ Prof. dr. Muhamet Bicaj, Fjalim me rastin e 3-vjetorit të themelimit të Universitetit të Tetovës, mbajtur në Akademinë Solemne kushtuar kësaj date, Gostivar, më 15.12.1997, në cilësinë e ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës së Republikës të Kosovës.

⁶⁵ Telegram nga prof. dr. Martin Berishaj, Fjalim me rastin e 3-vjetorit të themelimit të Universitetit të Tetovës, mbajtur në Akademinë Solemne kushtuar kësaj date, Gostivar, më 15.12.1997, si profesor nga katedra e Sociologjisë dhe Kulturës, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Lublanës.

objektiv. Në të kaluarën e afërt, shqiptarët e kanë pasur të vështirë që për një aktivitet kulturor të nxjerrin leje nga organet e rendit⁶⁶. Pengesat ligjore kanë qenë prezente edhe në jetën e përditshme, si në shkolla⁶⁷, çerdhe, spitale, institucione të arsimit të lartë e nëpër ministri e media. Deri në skajshmëri ishte planifikuar diskriminimi i gjuhës shqipe, derisa edhe emrat e qyteteve merrnin trajtën sllave të shqiptimit.

Referendumi i popullit shqiptar në Maqedoni u mbajt më 11 e 12 janar 1992. Vendimin për shpalljen e Referendumit për Autonomi Politike-Territoriale të Shqiptarëve në Maqedoni e bëri Kuvendi i Autonomisë, më 27 dhjetor 1991. Qytetarët shqiptarë duhej të deklaroheshin: “*A janë për Autonomi Politike-Territoriale të Shqiptarëve në Maqedoni*”⁶⁸. Por do e shohim se edhe përpjekjet ndërkombëtare 1992-2001 do të jenë të pasuksesshme pasi pala maqedonase mendonte se vetë do t’i zgjidhte vetë këto probleme⁶⁹, përfshirë edhe përdorimin e flamurit shqiptar,⁷⁰ i cili u hoq dhunshëm pas votimit në Parlamentin e Maqedonisë mes datës 8-9 korrik 1997⁷¹. Ambasadori Gert Arens thotë

⁶⁶ Intervistë me mësuesen Shpresa Sinani, 2 nëntor 2012. Për çdo organizim të aktiviteteve duhej leje nga zyrat e Sigurimit Shtetëror, të dërgohej lista e këngëtarëve që do të këndojnë, çfarë këngësh do të këndohen, agjenda etj., e gjitha kjo për të pasur një kontroll ndaj shqiptarëve.

⁶⁷ Qemal Halili, *Shkolla fillore Gjergj Kastrioti e fshatit Xhepçisht dhe Gjermë të Tetovës në retrospektivë dhe sot*, Tiranë: 2008, “Çabej”, f. 37. Mësues të inspektuar më datë 09.06.1952 ishin: Qerim Arifi, Reshat Jakupi.

⁶⁸ Zeqirja Rexhepi, *Zhvillimet politiko-shoqërore të shqiptarët në Maqedoni (1990-2001)*, Tetovë: 2006, f. 55-61.

⁶⁹ “Dosja e Zërit, Kriza në Maqedoni, Stabiliteti i Maqedonisë dhe marrëveshja historike maqedono-shqiptare”, në javoren politike shqiptare *Zëri*, 26 korrik 1997, f. 20. Këtu shihet përpjekja e ambasadorit Gert Arens për të ndërmjetësuar për zgjidhjen e problemeve mes shqiptarëve dhe maqedonëve, por shihet se has në pengesa pasi pala maqedonase i largohet përgjegjësisë.

⁷⁰ Pas zgjedhjeve të vitit 1996 shqiptarët filluan ta përdorin gjuhën shqipe dhe flamurin. Në komunikimin e pushtetit lokal me pushtetin qendror shqiptarët filluan të komunikojnë paralelisht në dy gjuhë: shqip dhe maqedonisht me qeverinë. Por qeveria përgjigjej vetëm në gjuhën maqedone. Bisedë me gazetarin dhe publicistin Qani Mehmeti, 20 dhjetor 2015.

⁷¹ Javore politike shqiptare *Zëri*, 26 korrik 1997, f. 9, 10, 11. Parlamenti i Maqedonisë më datë 8-9 votoi një ligj që ua ndalonte komunave shqiptare përdorimin e Flamurit Shqiptar, i cili përdorej krahas flamurit maqedonas. Pas votimit rezultoi se deputetët shqiptarë u mbivotuan dhe u soll vendimi, i cili rezultoi me intervenimin policor në godinën e komunës së Gostivarit duke hequr

se dialogu mes shqiptarëve dhe maqedonasve është i domosdoshëm.⁷² Por fatkeqësisht faktori ndërkombëtar duke pasur edhe angazhime të tjera në rajon nuk arriti t'i zgjidhë këto probleme edhe pse në vazhdimësi diplomatët dhe zyrtarët e huaj lëviznin nga Shkupi drejt Tetovës për bisedime mes palëve⁷³.

Gjykata Kushtetuese e RM lidhur me përdorimin e gjuhës shqipe

Lidhur me vështirësitë e përdorimit të gjuhës shqipe në institucionet e sistemit juridik, konkretisht në institucionet themelore gjendja paraqitet e tillë:

“Çështja e përdorimit të gjuhëve të bashkësive etnike, padyshim paraqet një nga sfidat më kruciale të funksionimit të demokracisë parlamentare në Republikën e Maqedonisë. Njëkohësisht kjo çështje është sfidë e funksionimit të shtetit multi-etnik. Edhe përkundër nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit në vitin 2001, ndryshimeve kushtetuese të cilat burojnë nga kjo marrëveshje, përsëri statusi i përdorimit të gjuhës shqipe mbetet një proces i hapur, nga vetë fakti i përdorimit jo të plotë të saj, në veprimtarinë e institucioneve themelore të sistemit juridik, politik të Maqedonisë. Në këtë drejtim është i rëndësishëm fakti se krahas mangësive të Kushtetutës dhe Ligjit për përdorimin e gjuhëve të bashkësive etnike, hasen mjaft vështirësi edhe në zbatimin praktik në institucionet ku ajo përdoret në harmoni me të njëjtën kushtetutë dhe ligjin përkatës”⁷⁴.

Gjuha shqipe si kategori kushtetuese në Maqedoni

“Në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare, gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe shkrimi i saj

flamurin dhe duke arrestuar e dënuar me burg kryetarin e saj Rufi Osmanin dhe kryetarin e këshillit Refik Dauti. Po ashtu e hoqi flamurin shqiptar nga godina e komunës së Tetovës dhe dënoi pastaj kryetarin e Tetovës Alajdin Demirin dhe kryetarin e këshillit, Vebi Bexheti.

⁷² Javore politike shqiptare *Zëri*, 26 korrik 1997, f.12, Dosja e Zërit, Maks van Der Shtul, Komisioner i Lartë i Minoriteteve pranë OSBE-së, artikulli me temë: “Si kurrë më parë nevojitet të intensifikohet dialogu maqedono-shqiptar”.

⁷³ Po aty.

⁷⁴ Intervistë e autorit të artikullit me dr. Jusuf Zejneli, ekspert për çështje kushtetuese-administrative, ligjërues në Fakultetin Juridik në Universitetin Shtetëror të Tetovës, datë 21 janar 2014.

cirilik. Gjuhë tjetër është shqipja, të cilën e flasin së paku 20% e shtetasve, gjithashtu, është gjuhë zyrtare dhe shkrimi i saj, siç është përcaktuar me këtë nen. Dokumentet personale të shtetasve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, lëshohen në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj, si dhe në atë gjuhë dhe shkrimin e saj në pajtim me ligjin.

Cilido shtetas i cili jeton në njësinë e vetadministrimit lokal, në të cilën së paku 20% e shtetasve flasin gjuhë zyrtare tjetër nga gjuha maqedonase, në komunikim me njësitë rajonale të ministrive, mund të përdorë cilëndo nga gjuhët zyrtare dhe shkrimin e saj. Njësitë rajonale, kompetente për ato njësi të vetadministrimit lokal, përgjigjen në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj cirilik, si dhe në gjuhën zyrtare dhe shkrimin të cilin e përdor shtetasi. Çdo shtetas në komunikim me ministrinë mund të përdor një nga gjuhët zyrtare dhe shkrimin e saj, ndërsa ministrinë përgjigjen në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj cirilik, si dhe në gjuhën zyrtare dhe shkrimin të cilin e përdor shtetasi”⁷⁵.

Marrëveshja e Ohrit dhe zyrtarizimi (i pjesshëm) i gjuhës shqipe

Konflikti i armatosur i vitit 2001 solli edhe kthesën e duhur për realizimin e arsimit të lartë dhe avancimin e gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare në Maqedoni. Që nga paraqitja e saj Ushtria Çlirimtare Kombëtare e artikuloi si kërkesë parësore heqjen e diskriminimit të shqiptarëve⁷⁶. Po ashtu këtë mund ta shohim edhe në një dokument që kërret e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare ua dërguan institucioneve më të larta ndërkombëtare, ku mes tjerash potencohet se shqiptarët duhet t’i gëzojnë të drejtat e shkollimit dhe përdorimit të gjuhës shqipe lirshëm⁷⁷. Po nga ky dokument vendoset edhe baza e asaj që më vonë do ndodhë.⁷⁸

⁷⁵ Po aty.

⁷⁶ Komunikatë e datës 09.03.2001, Shkup, Ushtria Çlirimtare Kombëtare, Shtabi i Përgjithshëm për masmedian, komunikata nr. 6. Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare drejtuar opinionit publik me rastin e komunikimit mbi spekulimet rreth veprimtarisë së tij. Ai komunikonte për të sqaruar pozicionimin e tij.

⁷⁷ Dokument origjinal i dedikuar organizatave më të larta ndërkombëtare, Departamentit të Shtetit Amerikan, Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Këshillit të NATO-s dhe OSBE-së, Ushtria Çlirimtare Kombëtare, kabineti i përfaqësuesit politik, Shkup, më 24 prill 2001, f. 6.

⁷⁸ Po aty.

Më vonë shqiptarët do ta realizojnë këtë objektiv deri në një masë⁷⁹. Marrëveshja e Ohrit realisht solli ndryshimet e shumëpritura⁸⁰. U përmirësua përdorimi i gjuhës shqipe në nivel lokal, duke avancuar në masë të madhe komunikimin me pushtetin qendror, avancoi përdorimin e dygjuhësisë, por jo edhe në nivel qendror. Përdorimi i gjuhës shqipe bëhej edhe më herët nga ana e pushtetit qendror, por përgjegjja gjithnjë ishte në gjuhën maqedonase. Po ashtu, filloi në masë të madhe që gjuha shqipe, deri atëherë e papërdorshme (me Kushtetutën e vitit 1991), të gjejë terren për përdorim.

Ministrat shqiptarë, deputetët, funksionarët shqiptarë në Parlament filluan që ta përdorin gjuhën shqipe në komunikim me institucionet. Rezistenca e palës maqedonase ka qenë shumë e madhe kundër përdorimit të gjuhës shqipe. Si gjatë viteve 90, po ashtu edhe në bisedimet në Ohër, ata nuk lëvizën nga pozicioni i tyre që gjuha shqipe të mbetet e margjinalizuar. Por insistimi i përfaqësuesve shqiptarë ka ndikuar në masë të madhe që gjuha shqipe të përdoret. Në këto rrethana mund të thuhet se me Marrëveshjen e Ohrit u bë maksimumi i mundshëm që gjuha shqipe të fitojë fizionomi juridike.

Definimi i përdorimit të gjuhës shqipe nuk është shumë i qartë. Ligji e lejon përdorimin e gjuhës shqipe, por e fut në një labirinth i cili nuk e shpjegon deri në fund përdorimin e saj të lirë. Por, ai vazhdon që ta hedhë në një Aneks më poshtë A, ku thuhet në Preambulën e Republikës së Maqedonisë, e cila e definon kështu gjuhën shqipe: "Cilado gjuhë tjetër të cilën e flasin së paku 20% e popullatës, gjithashtu është gjuhë zyrtare, si dhe shkrimi i saj, ashtu siç është përcaktuar më poshtë⁸¹. Realisht arsyetimi më poshtë tregon qartë se gjuha shqipe fiton statusin e një gjuhe zyrtare, por të kufizuar dhe nuk është gjuha e dytë zyrtare në Maqedoni.

Gjuha shqipe fiton një kornizë juridike dhe përdorimi i saj avancohet çdo ditë e më shumë. Por kjo kërkon punë sistematike, për të

⁷⁹ Po aty.

⁸⁰ Veton Latifi, *Zhvillimi i negociatave 1*, botim i Institutit për Studime Ndërkombëtare e Ekonomike, Ohër: 2006, f. 59-60.

Deklaratë e liderëve shqiptarë Arbën Xhaferi, Ali Ahmeti dhe Imer Imeri që njihet si "Marrëveshja e Prizrenit", e datës 21 maj 2001.

⁸¹ *DARM*, doss.1407 nalog 92/2013 g. Ohridski Ramkovenon Dogovor Ohrid, 13.VIII 2001 g, Skopje (kopje nga origjinali i Marrëveshjes Kornizë në gjuhën angleze).

avancuar deri në nivelin që e duan shqiptarët. Ajo që realisht duan shqiptarët është që të mund ta përdorin lirshëm gjuhën shqipe ashtu siç maqedonasit e përdorin gjuhën e tyre. Kjo kërkon kohë dhe kërkon mirëkuptim, por shqiptarët e kanë të qartë se nga duhet të lëvizin. Atë që MKO bëri, është që gjuha shqipe nga një përdorim shumë i vogël dhe i frikshëm kaloi në përdorim të pjesshëm, por që në njëfarë mënyre hap perspektivat e gjuhës shqipe, pavarësisht se pala maqedonase këtë e sheh si një çështje që u krijon shqetësime.

Zhvillimet rreth zyrtarizimit të gjuhës shqipe

Ligji për përdorimin e gjuhës vjen nga një rrugë e gjatë përpjekjesh politike në RM. Partitë e maqedonasve i kanë rezistuar një zhvillimi të këtillë, duke thënë se MKO dhe Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë ishin mjaft të qarta dhe për këtë shkak nuk ka nevojë për një ligj të tillë. Më 29 maj të vitit 2007, palët arritën një marrëveshje parimore me pesë pika, mes të cilave pika e katërt theksonte: *Palët partiake ranë dakord të hartojnë dhe paraqesin për miratim në Parlament një ligj mbi përdorimin e gjuhëve që është në pajtueshmëri të plotë me Marrëveshjen Kornizë dhe me Amendamentin e 5 të Kushtetutës. Palët ranë dakord për të vazhduar së punuari në grupe rreth kësaj çështjeje*⁸².

Interpretimi zyrtar i statusit të gjuhës shqipe në RM

Ligji materializon dispozitat e Amendamentit 5 dhe qartëson qëllimin e saj në disa fusha të institucioneve shtetërore dhe administratës. Më pas u hartua një draft nga fundi i vitit 2007, i propozuar nga VMRO-DPMNE-së gjatë negociatave me BDI-në, në kuadër të Marrëveshjes së 29 majit. Kërkesat e BDI-së të përfshira në ligj ishin:

1. Që të kalojë një Ligj për përdorimin e gjuhës shqipe. Për shumë vite, partitë maqedonase refuzonin të hartonin një ligj të tillë, duke konsideruar se nuk ka nevojë për të, meqë Kushtetuta dhe MKO ishin shumë të qarta rreth kësaj teme.

2. Gjuha Shqipe të mund të përdoret gjatë kryesimit të komisioneve parlamentare. Ky është një hap i rëndësishëm përpara (sidomos për deputetët e BDI-së) që kërkonin të realizohej kjo e drejtë.

3. Deputetët shqiptarë do të jenë në gjendje të marrin në Parlament material në gjuhën e tyre dhe alfabetin e tyre.

⁸² Gazeta *Lajm*, datë 30 maj 2007, Informacion i marrë në orën 15.30.

4. Shqiptarët mund të përdorin gjuhën shqipe në procedurat ligjore, të tilla si kriminale dhe në procedurën gjyqësore dhe kanë të drejtë të marrin të gjitha dokumentacionet legale në gjuhën shqipe. Ata gjithashtu kanë të drejtë të bëjnë rolin e përkthyesit pa pagesë.

5. Shqiptarët mund të përdorin gjuhën e tyre në korrespondencë me Ombudsmanin.

6. Librat e regjistrimit do të mbahen në komuna në dygjuhësi, në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën e çdo komuniteti, që përfaqëson më shumë se 20% të banorëve të asaj komune.

7. Artikuji të tjerë në lidhje me këtë (kjo duhet të adresohet për komente të veçanta).

Kërkesat e palës shqiptare* që nuk u realizuan

1. Pala shqiptare (BDI-ja) nuk arriti që ta bëjë gjuhën shqipe, gjuhë zyrtare në nivel shtetëror në gjithë territorin. Kështu, shqiptarët mund të shkruajnë në gjuhën amtare në institucionet qendrore të shtetit vetëm nëse ata banojnë në komunat ku ata përfaqësojnë më shumë se 20% të popullsisë⁸³, përndryshe janë të privuar nga kjo e drejtë.

2. Parlamenti nuk mund të drejtohet në gjuhën shqipe⁸⁴.

3. Gjuha shqipe nuk mund të përdoret si gjuhë pune në qeveri.

4. Gjuha shqipe nuk mund të përdoret nga gjyqtarë dhe prokurorë. BDI kishte kërkuar që shqiptarët të lejoheshin të zgjidhnin gjuhën e tyre si gjuhë gjyqësore.

5. Gjuha shqipe nuk mund të përdoret zyrtarisht në gjyqe. Megjithatë, ligji specifikon se ata mund të përdorin gjuhën e tyre dhe ata kanë të drejtë për interpretimin e lirë të deklaratës së tyre, si dhe përkthimet me shkrim të materialit të shkruar, e cila është relevante për procedurën gjyqësore.

* Bëhet fjalë për Bashkimin Demokratik për Integrim.

⁸³ *Doracak mbi legjislacionin kombëtar në sferën e përdorimit të gjuhëve të bashkësive etnike në Republikën e Maqedonisë*, Shkup, prill 2009, Fondacioni Shoqëri e hapur-Maqedoni, f. 39.

⁸⁴ Rafiz Aliti deklaroi që: “Kryetari i Parlamentit të Maqedonisë mban të drejtën të udhëheqë me seancat plenare duke ia pamundësuar atij që të drejtojë seancat në gjuhën shqipe”, në debatin me temë: “Gjuha shqipe në labirinthe të partive”, emisioni “Click Plus” transmetuar në “Radiotelevizioni 21”, Maqedoni, datë 27 tetor 2016.

6. Gjuha shqipe nuk mund të përdoret si gjuhë pune në ushtri dhe polici. Pavarësisht se në vendbanimet shqiptare, drejtuesit e policisë e përdorin midis tyre gjuhën shqipe, por zyrtarisht nuk e kanë të lejuar ta përdorin. Përveç gjatë procedurës së arrestimit apo legjitimitit të qytetarit, policët shqiptarë kanë të drejtë që shqiptarëve t'u drejtohen në gjuhën shqipe⁸⁵.

Implikimet nga përdorimi i gjuhës shqipe në institucionet e Republikës së Maqedonisë

Pas Marrëveshjes së Ohrit, gjuha shqipe vjen duke fituar terren për t'u bërë e përdorshme në institucionet shtetërore, por kjo nuk e ka rregulluar përdorimin e saj si gjuhë zyrtare. Kjo çështje kërkon një analizë më të thuktë, sepse edhe pas më shumë se një dekade mbetet e hapur për diskutim, si përplasje e vazhdueshme se sa përdoret gjuha shqipe zyrtarisht dhe cili është rregullimi i saj në nivel shtetëror. Kjo logjikë e qasjes së përdorimit të gjuhës shqipe krijon kokëçarje, sepse pengesat bëhen institucionale dhe vetë shqiptarët që janë pjesë e institucioneve më të larta shtetërore bien ndesh me këto ligje. Edhe sot, funksionarë shqiptarë komunikojnë vetëm me shqiptarët në gjuhën shqipe, në mënyrë të kufizuar*.

Në Maqedoni, diskriminimi i gjuhës shqipe fillon që nga faqja elektronike e qeverisë së Republikës së Maqedonisë, e cila është në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën angleze.** Retorika nacionaliste, e cila refuzon që shqiptarët të jenë pjesë e barabartë e sistemit, ky mentalitet mendon se nëse shqiptarëve u mundësohet përdorimi i gjuhës shqipe dhe nëse u bëhen lëshime, ata do të vazhdojnë që të kërkojnë më shumë të drejta. Diskriminimi vazhdon në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe në

⁸⁵ A. Sinani, *Moszyrtarizimi i gjuhës shqipe konform Marrëveshjes së Ohrit...*, f. 134.

* Sipas Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, ministrat shqiptarë e kanë të detyrueshme që në seancat plenare të Parlamentit të flasin në gjuhën maqedonase, që është një nonsens. Nëse një deputet duhet të komunikojë me një deputet tjetër shqiptar qoftë edhe nga partia e tij, ai nuk ka të drejtë që t'i përgjigjet në gjuhën shqipe. Kjo çështje kërkon një qasje për t'u zgjidhur, sepse realisht është e pakuptimtë që të mos mund të flitet në gjuhën shqipe. Këto pengesa elementare krijohen që të mos avancohet gjuha shqipe drejt institucioneve kapitale të Maqedonisë.

** Faqja zyrtare e qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

të gjitha ministratë e tjera që drejtohen nga maqedonas, ndërsa respektohet nga ministrat shqiptarë.

Aty ku shihet se si gjuha shqipe injorohet, është edhe Presidenca e Republikës së Maqedonisë⁸⁶. Presidenti*, që përfaqëson edhe shqiptarët, nuk e ka pa të arsyeshme të përdoret edhe gjuha shqipe në këtë institucion shumë të rëndësishëm për qytetarët. Komunikimi i këtij institucioni bëhet ekskluzivisht në gjuhën maqedonase dhe presidenti kurrë nuk e ka parë të arsyeshme që ta thotë një fjalë në gjuhën shqipe, si shenjë e pajtimit mes dy popujve.

I vetmi institucion nga tre shtyllat kryesore, siç janë kryeministri, presidenti dhe kryetari i Parlamentit, vetëm në këtë të fundit, në ueb-faqen e saj, gjuha shqipe është funksionale dhe mund ta shihni se ajo përdoret në nivel shtetëror.**

Ajo që lipset të ndodhë, kategorizohet në disa drejtime:

- Përdorimi i gjuhës shqipe në qeveri, që rregullon përdorimin e shqipes në institucionet ekzekutive të Maqedonisë, sepse nuk ka logjikë që në Parlament të përdoret dhe në qeveri jo. Kjo krijon një masë reduktimi apo përdorimi të pjesshëm të gjuhës shqipe;

- Përdorimi i gjuhës shqipe në Presidencë, që do të shikohej si sinjal i mirëkuptimit mes shqiptarëve dhe maqedonasve;

- Përdorimi i avancuar në nivel lokal.

Dobësitë e palës shqiptare janë:

⁸⁶ Shumë simptomatike është pritja e të dënuarit Johan Tarçullovski, i cili u gjykua nga Haga për masakrën e Lubotinit, ndërsa presidenti i bëri një pritje protokollare, gjë që bie në kundërshtim me të gjitha ligjet dhe normat njerëzore e juridiko-kushtetuese. Kjo tregon se thellë në vete, maqedonasit besojnë se J. Tarçullovski është një hero, sepse pritja iu bë nga institucionet shtetërore. Kjo është një çështje që tregon se institucionet maqedonase kanë problem në këtë drejtim, sepse Maqedoninë e konsiderojnë si të veten dhe të tjerët nuk duhet të kenë qasje. Presidenti maqedonas bëri një gafë të madhe duke i fyer shqiptarët me gjestin e tij. Të njëjtën gjë e bëri edhe kryeministri Nikolla Gruevski, i cili shkoi edhe më tutje, duke i bërë një pritje shtetërore në aeroport dhe duke i organizuar edhe një koncert në Shkup, që është një gjest që i fyen shqiptarët, pas masakrës së Lubotinit.

* Presidenti aktual Ivanov, në raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale, mori një numër simbolik të votave shqiptare.

** Faqja zyrtare e Parlamentit të Maqedonisë.

- Jo profesionalizmi dhe mospasja e një strategjie të qartë se nga lipset të lëvizë gjuha shqipe në nivel shtetëror;*

- Mungesë marrëveshjeje me palën maqedonase se gjuha shqipe të mos shikohet si rrezik, por si vlerë;

- Një periudhë kohore të sponsorizohet nga faktori ndërkombëtar përdorimi i gjuhës shqipe, si test për të tejkaluar maqedonasit kundërshtitë që kanë, duke i edukuar të rinjtë që ta pranojnë gjuhën shqipe**.

- Krijimi i një trupi mbipartiak, i cili do ishte i përbërë nga ekspertë të partive politike shqiptare, i cili do të merrej me identifikimin e problematikave dhe dhënies së solucioneve për zgjidhjen e pengesave që paraqiten, si rezultat i aparatit shtetëror që refuzon përdorimin e gjuhës shqipe.

Shtrirja e përdorimit të gjuhës shqipe

Nga 16 institucione që ishin objekt i hulumtimit dhe studimit del se ministritë që e përdorin gjuhën shqipe janë si vijon: Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Drejtësisë, Ministria Ekonomisë, Ministria e Mjedisit, Ministria e Pushtetit Lokal. Edhe Parlamenti i Maqedonisë e përdor lirshëm gjuhën shqipe, për dallim nga Qeveria dhe Presidenca që nuk e përdorin gjuhën shqipe.

Institucionet që nuk e përdorin gjuhën shqipe janë: Qeveria e Maqedonisë, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Shëndetësisë,

* Nga hulumtimet e atyre që punojnë nëpër institucionet shtetërore e që përfaqësojnë shqiptarët, vërehen shumë persona jokompetentë, të cilët kanë ardhur në rrugë partiake, familjare e miqësore e kështu me radhë, duke dëmtuar procesin dhe duke i dhënë një goditje të fortë Marrëveshjes së Ohrit. Kjo mungesë profesionalizmi e dëmton në masë të madhe Marrëveshjen e Ohrit dhe e parandalon jetësimin e saj në praktikë. Këtu fajin e ka politika dhe partitë, që duke i dhënë hapësirë njerëzve joprofesionistë kanë lejuar degradimin deri në këtë masë. Kjo vërehet nga viti 2001 e më pas.

** Çështja e përdorimit të gjuhës shqipe do të duhej të shkonte në drejtim të asaj që edhe maqedonasit të fillonin ta përdornin atë dhe kjo më së miri mund të bëhet tek të rinjtë. Ndërkombëtarët kanë mekanizma që mund ta fusnin përdorimin e gjuhës shqipe në shkolla dhe kjo do të ndikonte në masë të madhe në krijimin e një terreni për përdorimin e gjuhës shqipe në nivel qendror. Investimet në projekte të përbashkëta do të ishin që edhe maqedonasit të fillonin ta mësonin gjuhën shqipe, si një veprim që ndihmon në proceset integruese dhe këtë fuqi ndërkombëtarët e kanë dhe mund ta bëjnë.

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Financave, Ministria e Transportit dhe Ministria për Punë të Brendshme.

Institucionet që e përdorin pjesëshëm gjuhën shqipe janë: Ministria e Bujqësisë dhe e Transportit*.

Ajo që vërehet gjatë studimit të këtyre ueb-faqeve është se ministrat shqiptarë e respektojnë edhe përdorimin e gjuhës maqedonase, krahas asaj shqipe, për dallim nga ministrat maqedonas që në asnjë rast nuk e respektojnë gjuhën shqipe.

Injorimi i gjuhës shqipe në institucionet e vetëqeverisjes lokale

Problemi më i madh që paraqitet pas nënshkrimit dhe imple-mentimit të Marrëveshjes së Ohrit, është interpretimi i përdorimit të gjuhës shqipe, se është apo nuk është gjuhë zyrtare në Republikën e Maqedonisë. Kjo rezistencë ndaj përdorimit të gjuhës shqipe bëhet nga drejtues të institucioneve, si komunale që drejtohen nga maqedonasit e deri te kreu shtetëror, që thuajse as që dëshiron të dëgjojë për këtë problematikë.**

Çështja bëhet edhe më tragjike kur shqiptarët kanë mundësi ligjore që, nëpërmjet ligjit të Badinterit, i cili pengon sjelljen e ligjeve që janë kundër interesave të shqiptarëve me votim të dyfishtë dhe në raste konkrete mund ta bllokojnë punën e parlamentit, por një gjë e tillë deri më tash nuk ka ndodhur.

Diskriminimi në institucionet kulturore, arsimore e shkencore

Diskriminimi i shqiptarëve nuk përfundon vetëm në ministrinë apo agjencitë e shtetit, por aty fillon diskriminimi më i madh dhe vazhdon

* Ajo që bëjnë ministrinë, të cilat janë të ndërlidhura me institucione ndërkombëtare, si ato të BE-së, që u kushtojnë shumë rëndësi këtyre çështjeve, si respektimi i të tjerëve, tregon se kemi çështje që shihen me dy aspekte. Kjo çështje kërkon analizë, sepse mentaliteti i këtyre koniunkturave e ka bazën në Jugosllavinë e Titos, në të cilën maqedonasit i shtypnin shqiptarët dhe kjo mbetet edhe sot në metodologjinë e tyre, duke i shfrytëzuar dhe keqpërdorur mekanizmat shtetërorë për t'i realizuar këto objektiva.

** Problem më i madh paraqitet në qytetin e Shkupit, ku maqedonasit rezistojnë më së shumti, sepse gjithnjë në kohë të komunizmit, por edhe pas shpëputjes nga RFSJ, kanë përdorur vetëm gjuhën maqedonase dhe kjo krijon shumë vështirësi në qendër të Shkupit, ku ata rezistojnë ta përdorin gjuhën shqipe.

poshtë drejt institucioneve të tjera, të cilat do të duhej të ishin simbol i tolerancës në mes komunitetit maqedonas dhe shqiptar. Përvoja e mëhershme ka treguar për një injorancë të plotë të institucioneve kulturore. Ajo që prin në këtë fushatë për diskriminimin e shqiptarëve dhe që hapur e ka bërë një gjë të tillë, është Akademia e Shkencave dhe Arteve Maqedonase (MANU)⁸⁷.

Politika e deritanishme e kësaj Akademie ka qenë gjithnjë në kundërshtim të plotë me shqiptarët, duke mos i konsideruar si një komunitet shumë i rëndësishëm në Maqedoni dhe përfaqësimi këtu i shqiptarëve është jo vetëm simbolik, por është thjeshtë dekor, sepse shqiptarët që janë anëtarë të kësaj akademie nuk kanë as mundësi dhe as forcë që të bëjnë diçka më shumë për shqiptarët. Rasti i botimit të enciklopedisë skandaloze të hartuar nga kjo Akademi*, e cila i fyente shqiptarët, ishte një shprehje e politikës që ajo ka ndjekur për vite me radhë.

Instituti për Trashëgimi Kulturore e Shpirtërore të Shqiptarëve “Pjetër Bogdani”

Shqiptarët, pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit, krijuan disa institucione arsimore e shkencore të rëndësishme, në mesin e të cilave edhe Institutin për Trashëgimi Kulturore e Shpirtërore të Shqiptarëve⁸⁸. Ky institucion është mjaft i rëndësishëm për kulturën shqiptare dhe si i tillë do të duhej që t'i jepej rëndësi edhe nga aspekti i mbështetjes financiare. Ky institucion do të ndihmonte në krijimin e një rruge për intelektualët, shkollat shqipe dhe rritjen kombëtare të shqiptarëve. Por, ky institucion ballafaqohet, me mungesën e fondeve dhe mosfunksionimit të mirë, si rezultat i kësaj por edhe i disa arsyeve të tjera⁸⁹.

⁸⁷ Faqja zyrtare e MANU, Akademia e Arteve dhe e Shkencës maqedonase.

* Kjo enciklopedi në vitin 2008, i quajti shqiptarët “ardhacakë” dhe teksti i këtij botimi kishte shumë gjëra të pavërteta, që krijoi tensione në komunitetin shqiptar, të cilët protestuan derisa ky botim u fut në depo dhe u kyç me çelës. Por, historia e këtij botimi nuk përfundoi këtu, sepse i njëjti botim u shit nën dorë dhe u shpërnda, me të cilën u dëshmuua mostoleranca e maqedonasve.

⁸⁸ Faqja zyrtare e Institutit për Trashëgimi Kulturore dhe Shpirtërore të Shqiptarëve të Maqedonisë.

⁸⁹ A. Sinani, *Moszyrtarizimi i gjuhës shqipe konform Marrëveshjes së Ohrit...*, f. 158.

Përfundime

Nga ajo që u analizua për zyrtarizimin e gjuhës shqipe në Republikën e Maqedonisë, me theks të veçanta për periudhën pas nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit (2001-2013), dalin këto përfundime:

1. Gjuha shqipe nuk është plotësisht gjuhë zyrtare në Republikën e Maqedonisë;
2. Gjuha shqipe nuk përdoret lirshëm në të gjitha institucionet e Republikës së Maqedonisë;
3. Gjuha shqipe vazhdon të diskriminohet në dy drejtime:
 - a) Në pushtetin qendror (posaçërisht në pushtetin ekzekutiv);
 - b) Pjesërisht në pushtetin legjislativ ku ka përmirësime, por nuk janë të mjaftueshme;
4. Gjuha shqipe në vendbanimet ku numri i popullsisë shqiptare është nën masën 20%, është e ndalur dhe është e papërdorshme;
5. Në institucionet që nuk i drejtojnë shqiptarët, praktika e përdorimit të gjuhës shqipe mbetet e diskutueshme;
6. Në institucionet gjyqësore mbetet shumë për t'u bërë që gjuha shqipe të jetë gjuhë zyrtare, pasi ka kufizime dhe është e paqartë se deri ku mund të përdoret kjo gjuhë;
7. Ligjet e miratuara pas MKO-së, më 2001, 2008 dhe 2011 e avancojnë gjuhën shqipe, por nuk e zyrtarizojnë plotësisht;
8. Në Parlament lipset të ndryshohet rregullorja, për t'u mundësuar zyrtarëve shqiptarë të drejtojnë seancat në gjuhën shqipe;
9. Në Qeveri, po ashtu lipset të ndryshohet praktika e punës së saj, ministrave shqiptarë t'u mundësohet përmes ndryshimeve adekuate në rregulloret e punës, që të flasin në gjuhën shqipe, në seancat e punës së Qeverisë së RM-së;

Puna e këtij institucioni, që nga fillimi e deri më sot, konsiderohet si një vend për përplasje në mes partive politike shqiptare, të cilat më ndërhyrjet e tyre në shkencë dhe kulturë kanë krijuar hendek të madh edhe mes intelektualëve. Shkarkimet në baza partiake e kanë dëmtuar ndjeshëm këtë institucion shumë të rëndësishëm të shqiptarëve. Vazhdimisht ka pasur kundërthënie në punën e tij dhe pengesa nga institucionet qeveritare, të cilat e kanë penguar funksionimin e plotë të saj. Edhe sot, ky institucion funksionon me një buxhet shumë të ulët dhe shumë pak merret me çështjet, me të cilat do të duhej të merrej shkenca.

10. Në Gjykatën Kushtetuese lipset të ndërrohet praktika e punës dhe gjuha shqipe të jetë gjuhë që mund ta përdorin shqiptarët;

11. Të hiqet diskriminimi ndaj gjuhës shqipe në tërë territorin e Maqedonisë dhe krahas gjuhës maqedonase, gjuha shqipe të jetë në përdorim të plotë në çdo sferë të jetës publike;

12. Pala maqedonase, konkretisht kuadrot e partive politike maqedonase që drejtojnë institucionet shtetërore, njësoj siç e respektojnë shqiptarët gjuhën maqedonase, edhe ata ta respektojnë këtë parim, si një vlerë të shoqërisë në RM;

13. Në shtëpinë Muze të Nënës Terezë (në Shkup) të përdoret gjuha shqipe, pasi është diskriminim që në një institucion që është me vlerë monumentale për shqiptarët, të mos përdoret gjuha shqipe, posaçërisht kur bëhet fjalë për një figurë të përmasave të Nënës Terezë;

14. Në Institutin për Trashëgimi Kulturorë e Shpirtërore të Shqiptarëve të lejohet që gjuha shqipe të përdoret lirshëm (rasti i tabelës), pasi që edhe sot ky institucion nuk ka tabelë identifikuese, për shkak të kufizimit të gjuhës shqipe;

15. Të përdoret parimi i Badinterit që të mos tjetërsohet Marrëveshja Kornizë e Ohrit, në çështjet që janë kontestuese dhe që e mohojnë trashëgiminë kulturore, arsimore dhe gjuhësore të shqiptarëve;

16. Sekretariati për Implementimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit të jetë më konkret dhe të ketë qasje më serioze sa i përket implementimit të çështjeve, të cilat kanë mbetur pezull dhe të përdorë të gjitha mekanizmat, për t'i realizuar pikat kontestuese që e pengojnë jetësimin e MKO-së;

17. Partitë politike shqiptare të ndërtojnë strategji për çështje kapitale të shqiptarëve në RM, të mos lejohet diskriminimi i gjuhës shqipe dhe i çështjeve që janë prioritet për shqiptarët në Maqedoni;

18. Dialogu shqiptaro-maqedonas i inteligjencës të vazhdojë, që të krijohen rrethana që edhe pala maqedonase t'i pranojë vlerat gjuhësore e kulturore të shqiptarëve të Maqedonisë;

19. Të mos diskriminohen të rinjtë shqiptarë dhe nëpërmjet përdorimit të gjuhës shqipe t'u krijohet mundësi që të jenë pjesë e zhvillimeve në RM;

20. Zyrtarët maqedonas do të duhej ta mësonin gjuhën shqipe, si një gjest tolerance e mirëkuptimi me shqiptarët dhe të krijimit të klimës së mirëbesimit mes shqiptarëve dhe maqedonasve;

21. Të krijohet një grup pune i përbërë nga ekspertë shqiptarë, ndërkombëtarë dhe maqedonas, që Marrëveshja e Ohrit të implementohet plotësisht, pasi që ka zvarritje të çështjeve që shqiptarët i mban të pakënaqur dhe praktika ka treguar për ngecje në këtë drejtim.

Së fundmi, për t'u bërë shqipja gjuhë zyrtare në Republikën e Maqedonisë, lipset të ekzistojë vullnet politik, posaçërisht nga pala maqedonase, e cila ka nevojë të lirohet nga paragjykimet e shekullit të kaluar, duke bërë hapin e domosdoshëm që gjuha shqipe të jetë krahas gjuhës maqedonase, gjuhë zyrtare në Republikën e Maqedonisë.

S u m m a r y

THE OFFICIALIZATION OF ALBANIAN LANGUAGE IN LINE WITH THE FRAME AGREEMENT OF OHRID

The above article deals mainly with the problem of officialization of Albanian language in Macedonia after the signature of the Ohrid Agreement in 2001. It dwells somehow also on the period before its achievement concluding with some conclusions and obligations on its complete officialization in the future. The article even though dealing with a contemporary problem and in progressive process is based on important documentary and bibliographical sources and especially on the many interviews taken by the author himself. The author bears witness to knowing this problem very well, a problem on which he has dedicated also another book published by UET Press in 2014.

This study presents a contribution because of its values. It refers not only to concrete documents on the level of allowance of Albanian, but also on the range of its real usage in the local as well as central administration in the state of Macedonia. The author's conclusions on the advancement and institutionalization of Albanian as second official language in this country are a desire of the Albanians and an obligation for their political parties in this country.

